



Kadria NET
Kadri Haxhiaj
Drejtor
Istog

Ankesa Nr. 2016/256 KPM vs Kadria NET
Ref:1708/803/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2016/256 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Kadria NET (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 22 korrik 2015. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. KPM ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, e cila ka hyrë në fuqi më 28 korrik 2016. Me këtë Rregullore janë përcaktuar rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur, shpërndajnë përmbajtje audio dhe audiovizuale.
3. KPM, me datën 12 dhjetor 2016, ka pranuar një ankesë të parashtruar nga operatori i shpërndarjes KUJTESA NET ndaj operatorit të shpërndarjes KADRIA NET, duke pretenduar se me datën 7 dhjetor 2016, duke filluar nga ora 20:45, KADRIA NET i ka ritransmetuar ngjarjet e futbollit të Ligës së Kampionëve (Champions League), si vijon: Real Madrid-Dortmund nëpërmjet kanalit Tring Sport 1, Bayer-Monaco nëpërmjet kanalit Tring Sport 2, Lyon-Sevilla nëpërmjet kanalit Tring Sport 3 dhe Porto-Leicester City nëpërmjet kanalit Tring Sport 4.
4. KPM nëpërmes një shkrese me datën 13 dhjetor 2016 e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për ankesën e pranuar nga Pala Ankuese dhe e ka udhëzuar që brenda pesë (5) ditësh të ofrojë një sqarim lidhur me pretendimet e palës ankuese.
5. KPM, me datën 18 dhjetor 2016 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës mohohet t'i këtë ritransmetuar ngjarjet sportive të lartpërmendura, duke pohuar se

nga baza e tij nuk ka dalë sinjali që përmban kanale sportive, por që klientët mund të kenë qasje në pajisje të tjera që e mundësojnë një gjë të tillë.

6. KPM ka analizuar ankesën e Palës Ankuese së bashku me provën e deponuar (video-dëshmi), përgjigjen e Palës Përgjegjëse dhe në bazë të raportit të monitorimit të datës 21 dhjetor 2016, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, duke ritransmetuar ngjarjet e futbollit të Ligës së Kampionëve pa të drejtë të ritransmetimit.
7. KPM pas të gjeturave nga raporti i monitorimit, me datën 13 janar 2017, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje, duke e njoftuar për shkeljet e bëra dhe duke kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01. Po ashtu, në Njoftim paralajmërohet se dështimi për të vepruar në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, me automatizëm do të rezultojë me inicimin e procedurave ligjore në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.
8. KPM, për të verifikuar pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Rregulloren KPM-2016/01 pas Njoftimit për Shkelje, ka realizuar edhe një vizitë në terren. Në bazë të raportit të monitorimit, të datës 7 mars 2017, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse, ritransmeton katër grupe kanalesh nga i njëjti pranues (reciever): IPTV, FAV3, FAV4 dhe TË GJITHA. Nëpërmes këtyre ritransmeton kanale sportive e ndeshje të futbollit pa marrëveshje për të drejtat e ritransmetimit, si SUPER SPORT 2, SUPER SPORT 3 (Partizani-Tirana), SUPER SPORT 4, TRING SPORT 1 (Liga e Kampionëve; Man City-Monaco), TRING SPORT 2 (Liga e Kampionëve; Bayer–Atletic Madrid) dhe Film Aksion (kanal i platformës Digitalb), duke vazhduar të veprojë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2016/01.
9. KPM nëpërmes një shkrese të dytë, të datës 23 shkurt 2017, e ka njoftuar Palën Përgjegjëse për vizitën në terren dhe gjetjen e kanaleve për të cilat nuk posedojnë marrëveshje për ritransmetimin, duke e udhëzuar që në afat prej pesë (5) ditësh t'i ofrojnë ato marrëveshje.
10. KPM me datën 7 mars 2017 ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse, përmes së cilës sërish mohon të këtë ritransmetuar kanale për të cilat nuk posedon marrëveshje ritransmetimi dhe ngjarje sportive.

Analiza Ligjore

11. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse, ka bërë shkelje të nenit 5, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.

Neni 5, paragrafi 2 i Rregullores KPM-2016/01 përcakton se:

"I licencuari ka përgjegjësi për të garantuar se të gjitha shërbimet e programit të shpërndara përmes sistemit të tij të shpërndarjes janë në përputhje me Ligjin për KPM-në dhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën përkatëse".

12. KPM duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 5, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.
13. KPM me vizitën në terren ka gjetur se edhe përkundër Njoftimit për shkelje, Pala Përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.

Vendimi

14. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të vazhdueshme të nenit 5 paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.
15. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 5 paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01.

E drejta për Ankesë

16. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
17. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017

Datë